



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	26.05.2021
Referenc-ë:	07-353/04-92124/21
Për/ Za/ To:	“HANDIKOS”
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën tuaj me nr protokoll 07-353/04-92124/21 nga “HANDIKOS” me të cilën kërkohet që me datë 1 Qershor 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike „Sheshi ”Skënderbeu”, “Nëna Terezë” si dhe “Zahir Pajaziti” nga ora 11:00 deri në 18:00.

Qëllimi i aktivitetit është promovimi i parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me moton “ Bëhu mburoja ime” lidhur me këtë HANDIKOS planifikon të vendos tre instalacione (kukulla prej kartoni në formë të fëmijëve) në tre pika të sheshit të Prishtinës

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Skënderbeu”, “Nëna Terezë” dhe “Zahir Pajaziti” me datë 1 Qershor 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.